

UDHËZUES PRAKTIK PËR BASKETBOLLISTËT

Të drejtat, procedurat dhe
mekanizmat juridikë në FBK

Ky udhëzues ju ndihmon të kuptoni mekanizmat kryesorë në dispozicion të lojtarëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre brenda FBK-së.

PËRMBAJTJA

- 01** Të jesh lojtar në FBK
- 02** Kontrata jote
- 03** Regjistrimi, licenca dhe transferimi
- 04** Gjatë edicionit garues:
Kërkesë për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë
- 05** Pas përfundimit të edicionit:
Mbrotjtja e kontratës
- 06** Kujdesu për të drejtat e tua!

TË JESH LOJTAR NË FBK

- Si lojtar i regjistruar në FBK, marrëdhënia jote me klubin, regjistrimi, transferimi, licencimi dhe e drejta për të luajtur rregullohen nga aktet normative të FBK-së.
- Ti ke të drejtë të zgjedhësh klubin për të cilin dëshiron të luash, ndërsa marrëdhënia me klubin rregullohet përmes marrëveshjes së lidhur ndërmjet teje dhe klubit.
- Klubi ka detyrim të të njoftojë me Statutin dhe aktet normative të FBK-së, si dhe me rregulloret e klubit.

Mbaj mend:

Regjistrimi në FBK dhe licenca për të luajtur janë dy gjëra të ndryshme. Regjistrimi evidencon statusin tënd në FBK, ndërsa licenca të jep të drejtën të paraqitesh në ndeshje zyrtare.

KONTRATA JOTE

Marrëveshja ndërmjet lojtarit dhe klubit duhet të jetë e shkruar, e noterizuar dhe e regjistruar në FBK.

Përgjegjësia për deponimin dhe regjistrimin e kontratës në FBK i takon klubit.

Kontrata duhet të përcaktojë qartë, ndër të tjera:

- kohëzgjatjen e kontratës;
- kushtet e rinovimit dhe përfundimit;
- pagën dhe mënyrën e pagesës;
- bonuset dhe përfitimet tjera;
- detyrimet e lojtarit dhe klubit;
- kushtet për përfundimin e parakohshëm të kontratës.

Nëse kontrata nuk është deponuar nga klubi në FBK, kjo nuk e cenon vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtat e tua që rrjedhin prej saj.

Këshillë

Para se të nënshkruash

- **Lexoje kontratën**
- **Kupto kohëzgjatjen**
- **Kontrollo detyrimet financiare**
- **Mos nënshkruaj dokumente që nuk i kupton**

REGJISTRIMI, LICENCA DHE TRANSFERIMI

Regjistrimi të evidencon si lojtar të një klubi në regjistrin e FBK-së. Një lojtar mund të regjistrohet për maksimum dy klube gjatë një edicioni garues.

Licenca është ajo që të jep të drejtën të luash në ndeshje zyrtare. Për të luajtur duhet të jesh i regjistruar, të kesh licencë valide dhe të mos jesh i suspenduar ose duke vuajtur dënim.

Transferimi/kalimi bëhet, si rregull, gjatë afateve zyrtare kalimtare. Mund të transferohesh, ndër të tjera, kur kontrata ka skaduar, kur kontrata është ndërprerë me marrëveshje, ose kur të është njohur statusi i lojtarit të lirë me vendim përfundimtar.

Për lojtarët nën 18 vjeç kërkohet pëlqimi i prindit ose përfaqësuesit ligjor për regjistrim, transferim ose huazim.

GJATË EDICIONIT GARUES: KËRKESË PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË LOJTARIT TË LIRË

01 

Identifiko shkeljen e kontratës

P.sh. mospagesa ose mos-përmbushja e një detyrimi thelbësor.



02

Njofto klubin me shkrim

Kërko përmbushjen e detyrimit të papaguar brenda 10 ditësh.

03 

Prit 10 ditë

Klubi ka 10 ditë nga pranimi i njoftimit për të përmbushur detyrimin.



04

Klubi nuk e përmbush detyrimin?

Paraqit kërkesë këtu pranë KAA

Tarifa procedurale: 100 EUR

05 

KAA verifikon kërkesën

Verifikimi paraprak kryhet brenda 72 orëve nga pranimi i kërkesës.

06 

Vendimi i KAA-së

Nëse kërkesa aprovohet:

- kontrata shkëputet dhe fiton statusin e lojtarit të lirë;
- mund t'i bashkohesh një klubi tjetër pa kompensim;
- përcaktohet detyrimi financiar i klubit ndaj teje.

Afati për paraqitjen e kërkesës: Deri në fillimin e afatit kalimtar dimëror.

Baza juridike: Neni 31 i Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së.

SI TA MBROJ KONTRATËN TIME?

Ke kërkesa financiare nga edicioni i fundit garues?

01 

Paraqit kërkesën për Mbrojtjen e Kontratës këtu pranë KAA-së
Afati: 1 korrik – 31 korrik
Tarifa procedurale: 100 EUR

 02

KAA shqyrton kërkesën
 Nëse kërkesa vlerësohet e bazuar:

03 

Klubit i jepen 10 ditë për pagesë

 04

Klubi e përmbush detyrimin?
PO → Çështja përfundon
JO
 ↓

05 

KAA merr vendim

Vendimi merret brenda 5 ditëve nga skadimi i afatit të dhënë klubit.

06 

Klubi nuk e zbaton vendimin?

Klubi nuk mund të regjistrojë lojtarë të rinj deri në zbatimin e vendimit përfundimtar.

Nëse kërkesa jote aprovohet, klubi është i detyruar të rimbursojë edhe tarifën procedurale.

E rëndësishme: Kjo procedurë nuk nënkupton ndërprerjen e kontratës dhe nuk i jep lojtarit automatikisht statusin e lojtarit të lirë.

Afati për paraqitjen e kërkesës: 1 - 31 korrik të vitit përkatës.

Baza juridike: Neni 32 i Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së.

KUJDESU PËR TË DREJTAT E TUA

Para se të nënshkruash një kontratë, lexo dhe kupto detyrimet e tua dhe të klubit.

Mbaj kopje të:

- kontratës së nënshkruar dhe anekseve në rast se ka;
- dëshmive të pagesave;
- komunikimeve me klubin;
- dokumenteve të regjistrimit dhe transferimit;
- vendimeve dhe njoftimeve zyrtare.

Për çështjet që lidhen me FBK-në, komunikimi dhe dorëzimi i shkresave bëhet përmes Zyrës Ekzekutive të FBK-së, drejtpërdrejt, me email dhe/ose me postë.

Këshillë

Ruani gjithmonë kontratën, komunikimet dhe dëshmitë që lidhen me kërkesën tuaj.

DOKUMENTO. KOMUNIKO ME SHKRIM. RESPEKTO AFATET.

**Për çdo pyetje lidhur me të drejtat dhe procedurat e
përkrahura në këtë udhëzues, mund t'i drejtoheni:**

Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK)

ose

Shoqatës së Basketbollistëve dhe Basketbollisteve të Kosovës

*Ky udhëzues ka karakter informues. Në rast mospërputhjeje
ndërmjet këtij udhëzuesi dhe akteve në fuqi të FBK-së,
zbatohen aktet përkatëse të FBK-së.*